



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**V E N D I M**

**Nr. 62, Datë 04. 08. 2017**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 4, datë 16.01.2017, e M. L., ku pretendohet për diskriminim të djalit të saj, që vuan nga autizmi infantil, për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë Qytet dhe Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, ku mëson djali i ankueses.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

M. L. sqaron se, djali i saj është nxënës i klasës së tretë në shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, në Tiranë. Që në momentin e regjistrimit në klasën e tretë, në shtator të vitit 2016, ka kërkuar që shkolla të përgatisë planin individual PEI dhe më pas në zbatim të tij të caktohej një mësues ndihmës për të ndihmuar djalin e saj. Gjatë këtij viti shkollor ankuesja i është drejtuar në mënyrë të përsëritur drejtuesve të shkollës që të caktojnë një mësues ndihmës dhe është informuar prej tyre se është bërë kërkesë pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, por nuk kanë marrë ende një përgjigje. Lidhur me planin individual PEI, M. L. nuk është vënë në dijeni nga ana e drejtuesëve të shkollës, nëse është hartuar ose jo deri në këtë moment për djalin e saj. Në këto kushte, mos marrja e asnjë mase për ti ofruar djalit të saj arsim cilësor dhe gjithpërfshirës, duke përgatitur programin edukativo-individual PEI, si dhe caktimi i një mësuesi ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuar, i vendos këta nxënës në pozita diskriminuese.

E ndodhur në këtë situatë, ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesë, ku kërkon të ndërmerren masat e nevojshme nga ana e DAR Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, lidhur me:

- Përgatitjen sa më parë të programit edukativo-individual PEI, sipas kërkesave ligjore për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Caktimin e një mësuesi mbështetës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 38, datë 07.10.2014 “Kriteret e mësuesit ndihmës dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”, me qëllim që t’i sigurohet akomodimi i arsyeshëm sipas kërkesave specifike që ka nxënësi A. L.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

**Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërmori hapat proceduralë si më poshtë vijojnë :**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo nuk i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vijoi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr. 28/2 prot., datë 24.01.2017 është njoftuar M. L. dhe i është kërkuar dokumentacioni përkatës dhe informacion shtesë, mbi pretendimin e ngritur pranë KMD-së.

Më datë 15.02.2017, me anë të shkresës së protokolluar me nr. 168 prot. pranë KMD-së, ankuesja vuri në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, si dhe informoi se: *“...Më datë 09.02.2017, jam vënë në dijeni me dokumentacionin e ardhur nga DAR Tiranë dhe siç e kam shprehur edhe në ankesë, kam kërkuar që Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, të përgatisë një program PEI në përputhje me nevojat e A. L. dhe të caktohet një mësues ndihmës, që në momentin e rregjistrimit në këtë shkollë, përkatësisht në shtator të vitit 2016...Reagimi i shkollës dhe i DAR Tiranë ndaj kërkesave për përgatitjen e PEI dhe caktimin e mësuesit ndihmës ka ardhur vetëm në momentin që unë jam drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Më datë 31.01.2017, është bërë vlerësimi i A. L. dhe është përgatitur PEI. E njohur me përgjigjen e DAR dhe rekomandimin që mësuesi ndihmës të qëndrojë 4 orë në javë, shpreh shqetësimin se prania e mësuesit ndihmës është e pamjaftueshme, pasi ai do punojë me djalin tim për një kohë të pamjaftueshme. Takimet kaq të rralla nuk sjellin asnjë rezultat në arsimimin e A. L. pasi nevoja për mësues asistues është për çdo ditë në shkollë. Gjithashtu, caktimi i dy mësuesve ndihmës të cilët do të alternojnë këtë orar kaq të shkurtër, nuk më duket një zgjedhje e*

*mirë pasi nuk krijohet mundësia që A. L. të përshtatet me mësuesin ndihmës...Përsa më sipër, orët e caktuara për mësuesin ndihmës nuk përmbushin nevojat për asistencë në shkollë që ka djali im. E ndodhur në këto kushte, kërkoj që Komisioneri të vlerësojë me kujdes mënyrën e procedimit të institucioneve arsimore për caktimin e mësuesit ndihmës sipas nevojave që ka djali im, A. L., pasi mospërmbushja e detyrimeve ligjore vazhdon dhe e vendos atë në pozita diskriminuuese dhe çënon ecurinë e tij në shkollë. Gjithashtu, kërkojmë asistencën tuaj që t'i sigurohet akomodimi i arsyeshëm sipas kërkesave specifike që ka A. L., për caktimin e një mësuesi ndihmës gjatë gjithë kohës që ai është në shkollë.”*

2. Me shkresën me nr. 28/1 prot., datë 24.01.2017 është njoftuar Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë dhe Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, dhe i është kërkuar informacion mbi pretendimin e ngritur mbi rastin e nxënësit A. L.

Me shkresën me nr. 204/1 prot., datë 06.02.2017, DAR Tiranë Qytet dhe Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, informon Komisionerin lidhur me sa më sipër. DAR Tiranë Qytet sqaron se: *“...Në bazë të informacionit të përcjellë nga shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, theksohet fakti se nga ana e këtij institucioni arsimor është ngritur dhe funksionon rregullisht komisioni i nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nga ana e këtij komisioni deri në muajin dhjetor 2016, i është kërkuar në mënyrë të përsëritur prindërve të fëmijës A. L., raporti mjekësor apo vlerësimi i fëmijës nga institucioni arsimor në të cilin fëmija ka ndjekur studimet, por nga ana e tyre nuk është vënë në dispozicion ky dokumentacion, e dokumentuar kjo nga ana e shkollës së arsimit 9-vjeçar “Kongresi i Manastirit” Tiranë, me procesverbalin e datës 15.12.2016. Menjëherë pas vënies në dispozicion të raportit mjekësor më datë 03.02.2017, i cili përcakton diagnozën e këtij fëmije nga ana e shkollës së arsimit 9-vjeçar “Kongresi i Manastirit” Tiranë, është hartuar program individual PEI, për nxënësin A. L., pasi përgatitja e planit PEI është një detyrë e çdo mësuesi që ka nxënës me aftësi të kufizuara. Me Urdhërin Nr. 437, datë 10.10.2014, është ngritur edhe Komisioni Multidisiplinar pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qytetit të Tiranë, në përbërje të tij ka psikologë, punonjës social dhe mjek peditër, sipas përcaktimeve të Dispozitave Normative të arsimit parauniversitar 2013. Ky komision ka marrë në shqyrtim, ka ndjekur të gjitha procedurat dhe përgatitur të gjithë dokumentacionin e kërkuar si dhe rekomandimet përkatëse për të gjitha rastet e paraqitura në të nga vetë prindërit apo drejtuesit e institucioneve arsimore... Komisioni Multidisiplinar i ngritur pranë DAR Tiranë Qytet, pas vlerësimit të nxënësit në prani të prindit, mësueses dhe psikologes së shkollës, u caktua asistencë nga mësues ndihmës për 4 orë në javë dhe nga ana e shkollës, u caktua si mësues ndihmës për këtë nxënës, përkatësisht L. Z. dhe F. Z...”*

3. Në vijim të procedurave hetimore, referuar Urdhërit nr. 17, datë 16.02.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit pranë Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me

*ankesën e M. L.*”, ekipi i inspektimit të KMD-së, në datën 21.02.2017, kreu inspektim pranë Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë.

Gjatë inspektimit të zhvilluar në Shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, inspektorët e Komisionerit u takuan me L. M., me detyrë Drejtore e Shkollës, O. M., me detyrë psikologe e shkollës, si dhe me mësueset mbështetëse të nxënësit A. L., L. Z. dhe F. Z.

Në vijim, L. M. dhe O. M., u shprehën se pranë Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, ishte ngritur që në fillim të vitit shkollor, më datë 09.09.2016, Komisioni për nxënësit me aftësi të kufizuar.

Përsa i përket rastit në fjalë, u sqarua se: *“Nxënësi A. L. është rregjistruar në klasën e III-të, në këtë shkollë në muajin Tetor 2016. Në ndihmë të tij, sapo ai është rregjistruar në shkollë, si dhe me kërkesë të prindit, duke qënë se nxënësi ndiqte terapinë mbasdite, u vendos që klasa ku mëson nxënësi të zhvillojë mësimin paradite, si një lehtësi për nxënësin në fjalë. Klasa ku mëson nxënësi, përbëhet nga 35 nxënës, bashkë me A. L. Nga ana e shkollës është kërkuar në mënyrë të vazhdueshme, që M. L. të paraqesë Vërtetimin e KMCAP-së, lidhur me aftësinë e kufizuar të djalit të saj, por ky dokument është vënë në dispozicion më datë 31.01.2017, në momentin që pranë shkollës është paraqitur Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë. M. L. ka paraqitur kërkesë pranë shkollës për mësues ndihmës për djalin e saj, nga mesi i muajit Nëntor 2016 dhe në atë moment është vënë në dijeni nga ana jonë se kërkesa në DAR Tiranë është dërguar që në muajin Tetor 2016. Nxënësi që në momentin që është rregjistruar në shkollë ka patur mësues ndihmës, i cili ishte caktuar nga familja. Aktualisht nxënësi ndiqet nga 2 ditë në javë nga 2 orë në ditë, ndërsa 3 ditët e tjera të javës ndiqet nga mësuesi ndihmës i siguar nga familja. Aktualisht nxënësi asistohet 2 ditë në javë nga mësues ndihmës me nga 2 orë secila, ndërsa 3 ditët e tjera asistohet nga mësuesi ndihmës i siguar nga familja. Mësuesit ndihmës janë caktuar nga stafi i brendshëm i shkollës dhe nxënësi asistohet prej tyre çdo ditë të hënë dhe të premte, nga 2 orë në ditë.”*

Përsa i përket nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët asistohen nga mësues ndihmës, sipas informacionit të dhënë nga L. M. dhe O. M., në shkollën “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, ndjekin mësimin 6 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët, 2 janë në proces vlerësimi nga DAR Tiranë dhe 4 të tjerëve u janë caktuar mësuesit ndihmës. Në 4 rastet që nxënësit kanë mësues ndihmës, Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë, kishte caktuar që ata të asistoheshin nga mësuesit 3-4 orë në javë.

Në vijim të inspektimit, u mor takim me mësueset ndihmëse të nxënësit A. L., me F. Z. dhe L. Z., të cilat sqaruan se nxënësi në fjalë ka vështirësi në të nxënë, nuk arrin të artikulojë fjalë, nuk komunikon me fëmijët e tjerë të klasës, si dhe nuk është agresiv. Sipas tyre, 2 orë në ditë nuk

janë të mjaftueshme për nxënësin dhe ecurinë e tij. Herë pas here nxënësi bën sjellje të pavullnetshme, madje nuk arrin të qëndrojë ulur në bankë.

Në përfundim të inspektimit, O. M. shtoi se: *“Nxënësi A. L. nuk i mjafton, 4 orë në javë mësuesi ndihmës, madje mendoj që ai duhet të ndjekë arsimin special dhe jo atë të zakonshëm, pasi sjelljet që priten nga nxënësi dhe objektivat që janë vënë në PEI, nuk janë për një nxënës që duhet të mësojë në klasën e III-të, por për një fëmijë të një moshe shumë më të vogël.”*

Në dispozicion të grupit të inspektimit, përfaqësuesit e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, vunë kopje të të gjithë dokumentacionit të këkuar.

4. Në vijim të procedurave hetimore, ekipi i inspektimit të KMD-së, referuar Urdhërit nr. 16, datë 16.02.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *“Për kryerjen e inspektimit pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë Qytet, me qëllim marrjen e informacionit, lidhur me ankesën e M. L.”*, në datën 22.02.2017, zhvilloi inspektim pranë DAR Tiranë.

Inspektorët e Komisionerit u takuan me J. M., me detyrë Specialiste e Kurrikulës dhe Cilësisë, si dhe Kordinuese dhe Monitoruese për Komisionin Multidisiplinar të DAR Tiranë, me anëtarët e Komisionit Multidisiplinar të DAR Tiranë, E. D., me detyrë Psikologe Klinike, L. A., me detyrë Punonjëse Sociale, si dhe me O. J., me detyrë Psikologe Shkollore.

Përsa i përket rastit të nxënësit A. L., nga ana e përfaqësuesve të Komisionit Multidisiplinar, u sqarua se: *“Nxënësi A. L. është vlerësuar nga ana jonë, si dhe konstatuar që, gjendja e tij ishte e vështirë dhe Komisioni Multidisiplinar nuk ka rekomanduar që të ndjekë arsimin e zakonshëm por atë special, por me insistimin e prindit të fëmijës, u caktua që ai të ndjekë mësimin e zakonshëm me mësues ndihmës për 4 orë në javë. Komisioni Multidisiplinar ka rekomanduar që djali të mos vijojë arsimin e zakonshëm pasi nuk e ka potencialin e zhvillimit për të ndjekur këtë formë të arsimit. Ka patur edhe raste të tjera që prindërit edhe pas rekomandimit të Komisionit Multidisiplinar kanë nguruar të çojnë fëmijët në arsimin special. Duke qënë se Dispozitat Normative i kanë dhënë Komisionit Multidisiplinar attribute rekomanduese, atëherë është prindi ai që vendos për arsimin e fëmijës. Në këto kushte, fëmijët vijojnë të ndjekin arsimin e zakonshëm. Rasti i nxënësit A. L. në arsimin e zakonshëm mund të sjellë regres dhe jo progres, si për të por edhe për pjesën tjetër të nxënësve të klasës ku ai mëson. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni Multidisiplinar ka bërë me dije edhe prindin që djali me potencialin që ka, mund të pësojë regres në arsimin e zakonshëm.”*

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

**Për sa më sipër, gjatë procesit të hetimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ankuesi dhe palët kundrejt së cilës drejtohej ankimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi :**

**I. Lidhur me trajtimin ndryshe dhe të pafavorshëm, sa i përket caktimit të mësuesit mbështetës dhe hartimit të programit PEI.**

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimin të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.
- “*Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuara, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një *mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.*

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njësisive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: “*Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e*

*përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”.*

Megjithatë, për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, legjislacioni parashikon:

1. Në nenin 64, pika 3 i ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 93, të Urdhërit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave, parashikohet që: Si detyrim ligjor të njësisë arsimore vendore apo DAR-it, të krijojë një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

Pas kërkesës së paraqitur nga ana e shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë dhe prindit të fëmijës, si dhe shkresës<sup>1</sup> së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtuar DAR Tiranë Qytet, më datë 31.01.2017, Komisioni Multidisiplinar ka vlerësuar nxënësin A. L. në ambjentet e shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”. Mbështetur në Procesverbalin e mbajtur nga Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë, “Vlerësim i përgjithshëm i nevojave të fëmijës me AK”, rezulton se në përfundim të vlerësimit, komisioni ka rekomanduar se: “Nxënësi A. L. paraqet vështirësi të dukshme në procesin mësimor edukativ dhe në sjellje. Shfaq sjellje refuzuese, nuk ushtron kontroll mbi motorikën globale. Tenton të largohet nga ambjenti ku ndodhet. Pas vlerësimit komisioni gjykon se nxënësi A. L. Nuk përmbush kriteret për të ndjekur arsimin e zakonshëm. Me insistimin dhe dëshirën e prindit të fëmijës, komisioni bën rekomandim për mësues mbështetës.

Sikurse vihet re, nga parashikimet tepër të detajuara të legjislacionit<sup>2</sup>, DAR Tiranë ka detyrime tepër të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara që mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Tiranës.

---

<sup>1</sup> Nr. 28/1 prot., datë 24.01.2017

1. <sup>2</sup> DAR/ZA-ja ngre komisionin multidisiplinar të përbërë nga një mjek peditër (kur është e mundur, mjek peditër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.
2. Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.
3. Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij. Komisioni mblidhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor.
4. Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t'i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.
5. Prindi i paraqet komisionit pranë DAR/ZA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.
6. Komisioni:
  - a) njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;
  - b) i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjellas;

Në kushtet kur prindi është subjekti i cili vendos<sup>3</sup> nëse fëmija i tij duhet të ndjekë arsimin e zakonshëm apo atë special, Komisioni Multidisiplinar ka rekomanduar që nxënësi A. L. të asistohet nga mësues ndihmës në shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Mansatirit”, Tiranë.

2. Nga ana tjetër, neni 65, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon: “Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës”. Gjithashtu, Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon shprehimisht: “1. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngrë komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.”

Në nenin 96, pika 2, gërma b) të Urdhërit të sipërpërmendur parashikohet si detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor të zakonshëm të nxisë përmirësimin e jetës së nxënësve me AK në mjediset e institucionit arsimor. Dispozita e mësipërme përcakton shprehimisht se Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Këto masa përfshijnë edhe kërkesën drejtuar DAR Tiranë për mësues mbështetës.

- 
- c) sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;
  - d) rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;
  - e) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka.
  7. Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit mbështetës në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe funksionimit të aftësisë së kufizuar (standarde të Organizatës Botërore të Shëndetësisë).
  8. Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor.
  9. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK).
  10. Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale.
  11. Komisioni pranë DAR/ZA-së udhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësit me AK.
  12. Komisioni mban dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe përditëson ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin në institucionin arsimor.
  13. DAR/ZA-ja siguron kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.

<sup>3</sup> Referuar nenit 97, pika 6, të Urdhërit Nr. 343, datë 19.08.2013, përcaktohet se: Pas marrjes së rekomandimit nga komisioni pranë DAR/ZA, prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me AK do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.

3. Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen edhe mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kritereve të përcaktuara<sup>4</sup> me udhëzim të ministrit, kjo për t’u siguruar një kujdes akoma edhe më të veçantë, si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e tyre në shkollë.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit të nxënësit A. L., Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë, ka rekomanduar: *“Nxënësi i A. L., gjatë vlerësimit të aftësive për përvetësimin e programit mësimor-edukativ, si dhe problematikave sjellore që karakterizojnë diagnozën, shfaq nevojën e një mësuesi ndihmës”*. Krahas këtij rekomandimi, Komisioni gjithashtu sugjeron: *“Asistencë nga mësuesi ndihmës 4 orë në javë; Ndjekja e vazhdueshme e nxënësit me planin PEI në shkollë; Këshillim të vazhdueshëm mësues-psikolog-prind.”*

Pasi nxënësi u vlerësua dhe u dhanë rekomandimet përkatëse nga ana e Komisionit Multidisiplinar, drejtoresha e shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, ka caktuar si mësuese ndihmëse, dy mësuese të stafit të shkollës për të asistuar nga 2 orë në javë secila nxënësin A. L.

4. Në Shtojcën e Udhëzimit nr. 44, datë 16.10.2014 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e MASH nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucioneve të arsimit parauniversitar”,* parashikohet që: *Arsimi fillor (klasat I-V) dhe mësuesit sipas profilit: Profili i kërkuar “Arsimi i lartë për Ciklin Fillor (sistemi i vjetër, licencë mësuesi për arsimin fillor) dhe Profili i përafërt “E mesme pedagogjike për mësuesi, shkalla I e kualifikimit.”*

Sipas informacionit të administruar, mësueset ndihmëse të caktuara për nxënësit A. L., ishin F. Z. dhe L. Z., të diplomuara në degën Biologji-Kimi dhe të trajnuara si mësuese ndihmëse për fëmijët me vështirësi në të nxënë.

---

<sup>4</sup> 1. Sipas normës së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimit nga komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me AK, punojnë mësues ndihmës. Mësuesi ndihmës duhet të ketë diplomën e nivelit arsimor përkatës, të përcaktuar në nenin 57 të LAPU-s, dhe specializim të përshtatshëm në fushën e arsimit të nxënësve me AK.

2. Mësuesi ndihmës, në bashkëpunim me mësuesin lëndor dhe prindin, hartojnë dhe venë në jetë PEI-në e fëmijës. PEI bazohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës dhe përmban edhe objektiva për aftësitë e vetë-ndihmës dhe aftësi të tjera sociale, që nxënësi duhet të arrijë, sipas udhëzimeve të komisionit pranë DAR/ZA-së.

3. Mësuesi ndihmës shënon në planin ditari aspekte të ecurisë së fëmijës me AK.

4. Ndryshimi i PEI-t vendoset nga komisioni i institucionit në bashkëpunim me prindërit e fëmijës, pas propozimit të mësuesve ose prindërve.

5. Mësuesi ndihmës ose mësuesi kujdestar informon prindërit e fëmijëve me AK për shërbimet shtetërore shëndetësore rehabilituese që u ofrohen këtyre fëmijëve.

6. Pas marrjes së rekomandimit nga komisioni pranë DAR/ZA, prindërit vendosin nëse fëmija e tyre me AK do të ndjekë një institucion të specializuar ose të zakonshëm të arsimit bazë.

7. Prindërit mund të largojnë në çdo kohë nga shkolla fëmijën, kur gjykojnë se fëmija nuk përfiton nga mësimet ose ka mundësi të tjera më të mira.

8. Mësuesit dhe mësuesi ndihmës bashkëpunojnë me prindërit, në mënyrë që veprimtaritë, që zhvillohen në institucionin arsimor dhe në shtëpi të plotësojnë dhe të përforcojnë njëri-tjetrin.

5. Përsa i përket aftësisë së kufizuar të nxënësit A. L., bazuar në dokumentacionin<sup>5</sup> e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që vuan nga sëmundja Autizëm Infantil, si dhe nga ana e Komisionit Multidisiplinar të DAR Tiranë i është rekomanduar për një periudhë 3-vjeçare, përkujdesje të vazhdueshme nga një i afërm.

Referuar provave të administruara nxënësi A. L., ka ndjekur shkollën speciale “Luigj Gurakuqi” deri në muajin Tetor 2016. Në këtë shkollë nxënësi ka kryer klasën e tretë e më pas me anë të shkresës nr. 123 prot., datë 03.10.2016, ka marrë transferimin nga kjo shkollë për tu rregjistruar në shkollën 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë.

Në Vlerësimin Psikologjik të hartuar nga ana e Psikologes<sup>6</sup>, së Shkollës Speciale “Luigj Gurakuqi” Tiranë, citohet se: “...**Sjellja sociale:** Shmang në mënyrë të dukshme kontaktin me sy. Ka deficietetë theksuara në vëmendje dhe përqëndrim. Nuk ka interes për fëmijët e tjerë, nuk arrin të përfshihet në aktivitetet e grupit.; **Komunikim:** Arrin të flasë disa fjalë të shkëputura, por komunikimi i tij nuk është gjithmonë funksional, në mënyrë të vazhdueshme lëshon tinguj të pakuptueshëm; **Motorika globale:** Motorikën globale e ka të mirë, por nuk ushtron kontroll mbi muskujt e mëdhenj në formën e një sjellje refuzuese kundrejt çdo tentative që bëhet nga të rriturit për ndërveprim; **Motorika fine:** Motorikën fine e ka gjithashtu të dobët si një formë refuzimi ndaj kërkesës për bashkëpunim; **Orientimi në kohë dhe në hapsirë:** Nuk orientohet minimalisht në mënyrë të pavarur në kohë e hapsirë; **Zhvillimi konjitiv:** Nuk arrin të kryej relacione të thjeshta të përditshmërisë, nuk arrin të zgjidh situata të thjeshta të jetës së përditshme. Në pjesën e aftësive shkollore nuk shfaq ndonjë arritje: arrin të mbaj lapsin vetëm me ndihmë.”

Mbështetur në informacionin e administruar gjatë procedurave hetimore, në shkollën 9-vjeçare mësonin 6 nxënës me aftësi të kufizuara, nga të cilët 4 prej tyre ishin vlerësuar nga ana e Komisionit Multidisiplinar të DAR Tiranë Qytet dhe u ishte caktuar mësuesi mbështetës. Në 2 prej rasteve mësuesit mbështetës ishte caktuar 3 orë në javë, ndërsa në 2 raste (1 prej rasteve është edhe nxënësi A. L.) të tjera mësuesit mbështetës janë caktuar 4 orë në javë.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara, konstatohet se nxënësi A. L. është trajtuar në mënyrë të barabartë me nxënësit e tjerë me aftësi të kufizuara të Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, kur nuk ndodhen në të njëjtat kushte. Pra, pavarësisht faktit që nxënësi A. L. ka vështirësi më të dukshme në të nxënë krahasuar me nxënësit e tjerë të shkollës, me të njëjtën diagnozë, u janë caktuar mësuesit ndihmës 3-4 orë në javë njëjloj si ai.

Referuar konstatimeve të bëra nga Komisioni Multidisiplinar i DAR Tiranë, si dhe i psikologes së shkollës, nxënësi nuk mund të ndjekë arsimin e zakonshëm, pasi sjellja e tij dhe objektivat që janë vënë në planin PEI, nuk janë për një fëmijë të një moshe të klasës së III-të, por për një

<sup>5</sup> Vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Nr. 69, datë 06.01.2015.

<sup>6</sup> E. D.

fëmijë të një moshe shumë më të vogël. Gjithashtu, ndjekja e shkollës së zakonshme nuk mund të sjellë progres për një fëmijë në kushtet e nxënësit A. L. por vetëm regres në të nxënë.

Pavarësisht vlerësimit të bërë nga ana e Komisionit Multidisiplinar të DAR Tiranë, si dhe i psikologes së shkollës, asistenca me 4 orë në javë me mësues ndihmës, tregon se nuk janë mbajtur parasysh nevojat e shkollimit të nxënësit A. L..

## **II. Lidhur me trajtimin në mënyrë të diferencuar për shkakun e pretenduar nga ankuesi, Komisioneri gjykon se:**

**Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.**

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se nxënësi A. L., pas procedurave të shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga ana e DAR Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë, janë marrë masa pozitive, duke hartuar planin PEI dhe caktuar mësuesit ndihmës.

Përsa i përket, nxënësit A. L., siç u pohua edhe nga ana e përfaqësuesve të shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Mansatirit” dhe DAR Tiranë Qytet, ai asistohet 4 orë në javë nga 2 mësueset ndihmëse të caktuara nga shkolla dhe pjesën tjetër nga mësuesi ndihmës i siguruar nga familja.

*Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se, caktimi i një mësuesi ndihmës për 4 orë në javë, për një nxënësi i cili duhet<sup>7</sup> të ndjekë arsimin special dhe jo atë të zakonshëm, nuk është aspak i mjaftueshëm. Pra, kjo situatë e vendos në pozita diskriminuese, duke u trajtuar në mënyrë të barabartë me nxënësit të tjerë të shkollës të cilët nuk janë në të njëjtat kushte me të dhe i cënon ecurinë në shkollë.*

**Përsa më lart, nxënësi A. L. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN dhe në ligjin për Arsimin Parauniversitar përmes:**

- *mospërfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënësit gjatë të gjithë kohës që ndjek mësimin, pavarësisht faktit se Komisioni Multidisiplinar dhe përfaqësuesit e shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, pohojnë se arsimi i zakonshëm sjellë regres për nxënësin.*
- *caktimit të mësuesve ndihmëse jashtë profilit të caktuar në Udhëzimin nr. 44, datë 16.10.2014.*

---

<sup>7</sup> Referuar vlerësimit të Komisionit Multidisiplinar të Drejtorisë Arsimore të Qytetit Tiranë

Kjo bën që nxënësi A. L., të mos marrë shërbimin që duhet t'i ofrohet sipas parashikimeve të DN<sup>8</sup> dhe të cënohen në të drejtën e tyre për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimit në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Këtë frymë kanë ruajtur dhe Ligji “Për arsimin parashkollor” dhe Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, ku përcaktohen qartë detyrimet e të gjitha strukturave për të garantuar të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar dhe për të garantuar një arsim gjithëpërfshirës.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, 2, 7, 19, 32, pika 1, germa c), nenin 33, pika 10, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3, të Ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96 të Urdhërit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të nxënësit A. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e DAR Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, përmes mospërfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënësit gjatë të gjithë kohës që ndjek mësimin.
2. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Shkollës 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit”, Tiranë dhe DAR Tiranë Qytet, që nxënësi A. L. të vlerësohet edhe një herë nga ana e Komisionit Multidisiplinar, si dhe t'i caktohet një mësues ndihmës për gjatë të gjithë kohës që ai e ka të nevojshme.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Shkolla 9-vjeçare “Kongresi i Manastirit” dhe DAR Tiranë Qytet, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.

---

<sup>8</sup> Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**KOMISIONERI**

---

**Irma BARAKU**

(Shkaku: Aftësi e kufizuar)

(Fusha: Arsim)